



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-66
Prishtinë, më 26 maj 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 26 MAJ 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci dhe Xhezair Murati, ndërsa munguan, me arsye Xhavit Haliti, Naim Maloku dhe Slobodan Petroviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Regjepi, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Petrit Hysaj

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe për tri pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit.

Në fillim të mbledhjes anëtari i Kryesisë, **Xhezair Murati**, paraqiti qëndrimin e Grupit Parlamentar “7+”, për ndërrimin e anëtarit të Kryesisë nga radha e komunitetit joshqiptar dhe joserb, si dhe të kryetarin e këtij grupit parlamentar.

Ai falënderoi anëtarët e Kryesisë së kuvendit për bashkëpunim gjatë këtij mandati, në të cilin tha se është angazhuar maksimalisht që të kontribuoj.

Kryetari falënderoi **Xhezair Muratin** për angazhimin dhe kontributin e tij të deritashëm në Kryesinë e Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 maj 2009;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore. (proponohet që të radhitet për seancë plenare më 28 maj 2009, si pikë plotësuese),
3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës,
4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe të Mbeturinave,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media dhe të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Raportin financiar të Radio-Televizionit të Kosovës, për vitin 2008,
6. Shqyrtimi i Kërkesës për kompensimin e Komisionit të posaçëm për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i Kërkesës për kompensimin e Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit,
8. Shqyrtimi i kërkesës së Administraturës Apostolike të Prizrenit për mbështetje dhe patronat në manifestimin përkujtimor me rastin e 2000-vjetorit të lindjes së Shën Palit,
9. Shqyrtimi i mundësisë për ndarjen (rindarjen) e kryesuesve të komisioneve parlamentare,
10. Shqyrtimi i propozimit për ridestinimin e mjeteve për investime kapitale.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 maj 2009.

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 maj 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore

Kryetari njoftoi Kryesinë me kërkesën e Qeverisë së Kosovës që ky projektligj të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar, në pajtim me Rregulloren e punës.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Qeverisë së Kosovës, vendosi që Projektligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore t'ia propozojë seancës plenare më 28 maj 2009, për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Propozimvendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës

Kryetari njoftoi Kryesinë për vendimin e Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës, si dhe për rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me këtë.

Kryesia vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet për seancën plenare në fillim të muajit qershor 2009.

4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe të Mbeturinave

Kryetari njoftoi Kryesinë për vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe të Mbeturinave.

Kryesia, pasi shqyrtoi vendimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që ta shqyrtojë vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit të Ujërave dhe të Mbeturinave dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandim.

5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media dhe të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Raportin financiar të Radio-Televizionit të Kosovës, për vitin 2008

Kryetari njoftoi Kryesinë lidhur me rekomandimet e Komisionit për Shërbime publike, Administratë Lokale dhe Media dhe të Komisionit për Buxhet e Financa për Raportin financiar të Radio-Televizionit të Kosovës për vitin 2008.

Kryesia , pasi diskutoi për këtë çështje, vendosi që kjo pikë të radhitet për seancë plenare të muajit qershor 2009.

6. Shqyrtimi i Kërkesës për kompensimin e Komisionit të posaçëm për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit të posaçëm për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në shumën prej 50 €, ndërsa për stafin mbështetës të komisionit 30€, për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, realizohet sipas evidencës për pjesëmarrje në mbledhje.

7. Shqyrtimi i Kërkesës për kompensimin e Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit, në shumën prej 50 €, ndërsa për stafin mbështetës të Panelit 30€, për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, realizohet sipas evidencës për pjesëmarrje në mbledhje.

8. Shqyrtimi i kërkesës së Administraturës Apostolike të Prizrenit për mbështetje dhe patronat në manifestimin përkujtimor me rastin e 2000-vjetorit të lindjes së Shën Palit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Administraturës Apostolike të Prizrenit që Simpoziumi shkencor për kremtimin e Vitit Jubilar kushtuar Shën Palit, të mbahet nën patronatin e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Kryesia mbështet organizimin e këtij simpoziumi me mjete financiare në shumën prej 2000 (dymijë) eurosh.

9. Shqyrtimi i mundësisë për ndarjen (rindarjen) e kryesuesve të Komisioneve parlamentare

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që të përgatitë një informatë për numrin dhe përbërjen e komisioneve parlamentare, bazat dhe kriteret e përfaqësimit të grupeve parlamentare në komisione, si dhe propozimin për zvogëlimin e mundshëm të numrit të anëtarëve në disa komisione parlamentare mbi bazën e vëllimit të punëve.
2. Informata nga paragrafi një (1) i këtij përfundimi t’i paraqitet Kryesisë së Kuvendit në mbledhjen e radhës, për shqyrtim.

10. Shqyrtimi i propozimit për ridestininimin e mjeteve për investime kapitale

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lartë, mori këtë

V E N D I M

I. Kërkesë Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financa për lejimin e transferimit të mjeteve buxhetore, si dhe kërkimi i buxhet shtesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, si vijon:

a) Nga projekti Vila “Gërmia”, në vlerë prej 850.961 € në kuadër të programit 10200 -kërkohet ridestিনিmi në të njëjtin program, por në projekte të reja:

| | |
|---|------------|
| 1. Ndërrimi i dyerve dhe i dritareve | 350,000 €, |
| 2. Renovimi i ujësjellësit dhe i kanalizimit | 250,000€, |
| 3. Pajisje të përkthimit me emetim dhe pranues digjital për sallën e Kuvendit të Kosovës..... | 35,000€, |
| <hr/> | |
| Gjithsej | 635,000€ |

Ndërsa pjesa prej 215,961€ vazhdon të mbetet në kuadër të projektit ekzistues Vila “Gërmia”.

b) Nga Projekti rinovimi i aneksit të bëhet ridestininimi për projektin në vijim:

| | |
|--|-----------|
| 1. Rinovimi i dy sallave dhe furnizimi me pajisje dhe mobile përcjellëse | 111,500€, |
| Gjithsej..... | 111,500€. |

c) Nga programi 10100 - nga kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje të transferohet shuma prej 220.000 € për projektin kapital - Blerja e veturës për nevoja të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

d) Kërkohej buxhet shtesë që nevojitet për t'i mbuluar shpenzimet të cilat do të ndodhin deri në fund të vitit 2009:

- Për udhëtime zyrtare dhe diplomaci parlamentare.....130,000€,
- Për trajnimin e deputetëve dhe të administratës.....130,000€.

Gjithsej: 260.000€.

e) Po ashtu, të njoftohet Ministria e Ekonomisë dhe e Financave se Kuvendi është në pritje të shqyrtimit të dy ankesave gjyqësore:

- Kontesti me KEK-un, vlera 70.000 €, dhe
- Kontesti me Administratën Tatimore në vlerë prej 680.687 € për pagesën e borxheve tatimore për vitet 2003-2007.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**